

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 377, datë 26.4.2017

P Ë R

**DHËNIE PENSIONI TË POSAÇËM FAMILJARËVE NË NGARKIM
TË TË NDJERIT ANDREA STEFANI**

Në mbështetje të nenit 5, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Dhënie, përjashtimisht nga kriteret e vendimit nr.429, datë 12.2.2002, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të një pensioni të posaçëm familjar për personat në ngarkim të të ndjerit Andrea Stefani.
2. Pensioni i posaçëm familjar ose shtesa e pensionit familjar të jetë deri në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë në muaj. Përfitues të pensionit ose shtesës së pensionit janë personat e përcaktuar sipas kushteve që parashikon neni 40, i ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. Shuma, kur kërkohet nga familjarët, jepet e ndarë në mënyrë të barabartë për çdo përfitues.
3. Efekti financiar, prej 400 000 (katërqind mijë) lekësh, për vitin 2017 dhe për

vitet në vazhdim, të përballohet nga buxheti i sigurimeve shoqërore.

4. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, botohet në “Fletoren zyrtare” dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.5.2017.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

NIKO PELESHI

MINISTRI I KULTURËS

MIRELA KUMBARO FURXHI